



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafit_ dhe nenit 23 paragrafit 1 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit për korrupsion nga parashtruesi nga, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK) në vazhdimin e seancës së 45-të të mbajtur me datë 29.12.2020 morri

VENDIM

Procedura për lëndën 12-3366 ga viti 2019, formuar pas denoncimit nr. 12-3366/1 me datë 01.07.2019, dorëzuar nga parashtruesi nga , **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutjshëm për lëndën 12-3366 nga viti 2019, në denoncimin e dorëzuar ka vepruar organ tjetër kompetent kurse proedura e lëndës është ndërprerë.

Lënda me numër 12-3366 nga viti 2019, të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i Komisionit shtetëror, me sqarimin.

Vendimi i Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, me sqarimin – në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e marrjes së vendimit.

Sqarim

Lënda me numër 12-3366 nga viti 2019 është formuar pas denoncimit nr. 12-3366/1 me datë 01.07.2019, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit, nga parashtruesi nga

Denoncimi i marrur përmbanë akuza për kryerje të shtypjes (ndikimit) mbi personin e punësuar në administratët e Komunës së, gjegjësisht për veprim joligjor nga ana e Kryeprefektit të Komunës në lidhje me ndërmarrjen e ingirencave në vendin e punës në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Gjatë rishikimit të rastit të lëndës, KSHPK i merr parasyshë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të caktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek Inspektorati shtetëror administrativ në RMV, në përputhje me kompetencat e veta ligjore, të bënë inspektim mbikqyrës në zbatimin e Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative dhe ligje dhe rregulla që përmbajnë dispozita për perocedurë dhe veprim të rregullave për punë në zyrë në Komunën e lëndës. Njëherit, nga Komuna është kërkuar informacione dhe të dhëna në lidhje me rastin e lëndës.

Pas kërkesës së Komisionit shtetëror janë dorëzuar njiptime me informacionet e kërkuara me shtesë dokumentacion dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë me të cilin disponon për rastin e lëndës, nga ana e KSHPK është caktuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret bëhet fjalë për pengesa në kryerjen e detyrës së punës të parashtruesit të denoncimit, i cili ka qenë i punësuar në administraton e komunës në vendin e punës

vëzhgim administratori në sistemin për e-leje, e-urbanizëm dhe e-tokë ndërtimore , e cila mund të jep role dhe emëtime të shfrytëzuesve të e-leje, e-urbanizëm dhe e-tokë ndërtimore, mirëpo nuk ka mundësi të bënë ndryshime të të dhënave në sistem.. Përveç administratorit të komunës si informatikant me kontratë në vepër është punësuar edhe mirëpo i njëjti nuk ka marrë rol nga administratori i BNJVL për qasje në e-sistemin.

- Në bazë të Vendimit nr. /1 me datë 20.22.2022 miratuar nga Qeveria e RM, komuna ka marrë të drejtën të menaxhon me tokën ndërtimore në pronësi të RM, në përputhje me Ligjin për toka ndërtimore ku janë caktuar kushtet se si të menaxhohet me tokën e komunës
- Që të fiton Autorizimin përkatës, disa persona zyrtar të caktuar është dashur të ndjekin trajnime të organizuara nga BNJVL. Kryeprefekti i komunës në përputhje me nenin 56 paragrafi 1 nga Ligji për tokë ndërtimore (Gazyta Zyrtare e RM, nr. 117/11, 53/11) me vendim nr. /1 me datë 25.08.2011 formoi Komision për realizimin e procedurës për ankant publik për tjetërsim dhe dhënje me qira të tokës ndërtimore në pronësi të RM për rajonin e komunës, në të cilën në mes tjerash si anëtarë ka qenë edhe parashtruesi i denoncimit. Të gjithë anëtarët e këtij komisioni kanë fituar Autorizimet e nevojshme, gjë që është konstatuar nga inspektimi i bërë.
- Në lidhje me kërkesën për kontrollë të veprimt të komunës, për lëndën e formuar me kërkesë të dorëzuar në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ për tokë ndërtimore, i arkivuar në formë elektronike me numër në librin e regjistrimit me datë 19.03.2019 për tjetërsim të tokës ndërtimore në pronësi të RM për formimin e parcelës ndërtimore të paraparë me planin urbanistik ose dokumentacionin e planifikim urbanistik nëse personi ka në pronësi më shumë se 30% e parcelës ndërtimore, e cila është parashtruar në formë elektronike nga ana e personit, është konstatuar se: Lënda është filluar me punë nga ana e Udhëheqësit të Njësisë për menaxhim me tokë ndërtimore të RM për formimin e parcelës ndërtimore të paraparë me planin urbanistik ose dokumentacionin e planifikimit urbanistik nëse personi ka në pronësi më shumë se 30% nga parcela ndërtimore nga , me shtojcë dokumentacion i nevojshëm për të njëjtat. Në lëndën është miratuar Vendim me datë 12.06.2019, i cili është prëgaditur nga ana e Udhëheqësit të Njësisë për menaxhim me tokë ndërtimore dhe pronë të patundshme në komunën , e obliguar për punë me këtë lëndë, me të cilën e rrefuzon kërkesën si të pa bazë.

Në sistemin e-tokë ndërtimore është dërguar në miratim deri tek ndihmësi i udhëheqësit të Sektorit, mirëpo nga ana tij është treguar se për lëndën nuk veprohet për arsye se me datë 16.08.2019 nga ana e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar deklaratë e volusur në noter me datë 06.08.2019, me të cilën tërhiqet nga kërkesa për tjetërsim të tokës ndërtimore në pronësi të RM për formimin e parcelës të paraparë me planin urbanistik ose dokumentacionin e planifikimit urbanistik nëse personi

ka pronësi të më shumë se 30% nga parcela ndërtimore PK nr., PK nr...../2, PK/1 dhe PK/1 KK, të përmendura në elaboratin gjeodezik për të dhëna numerike për realizim të planeve urbanistike dhe dokumenteve për planifikim urbanistik. Nga ana e personit zyrtar i cili ka qenë prezent gjatë inspektimit i është treguar se nuk është në rrjedhë me veprimin e mëtutjeshëm për lëndën, pasi që ka përgaditur vendimin nr. me datë 14.06.2019, gjegjësisht rreth dy muaj nuk ka pasë qasje deri tek sistemi informativ i e-tokës ndërtimore, për çka gojarisht i është treguar nga ana e shërbimi informativ pran komunës gjegjësisht nga informatikanti, duke mos marrë lajmërim me shkrim për të njëjtën. Me këtë i është shkurtuar e drejta për regjistrim, shpërndarje të lëndëve dhe qasje në shpërndarjen e lëndëve tek nënpunësit tjerë nga Njësia për menaxhim me tokën ndërtimore dhe pronën e patundshme në Komunë, ku me Vendim për përparim në karrierë me datë 28.09.2018 është emëruar për udhëheqës i të njëjtës.

Nga mbikqyrja e bërë dhe kontrolli në evidencën është konstatuar se pas parashtrimit të deklaratës për tërheqje nga ana e parashtruesit të kërkesës, nga ana e organit nuk është ndërmarrë akt i rregullt për ndërprerje të procedurës, në përputhje me nenin 54 nga LPPA, me çka nga ana e inspektorit administrativ është marrë vendim me të cilën e obligon kryeprefektin e komunës të vepron për të njëjtën në afatin e caktuar. Në bazë të kompetencave të caktuara me Ligjin për inspektim administrativ, inspektori administrativ, ka përgaditur procesverbal të gjendjen e konstatuar II1 nr. ... me datë 11.09.2019 dhe për mangësitë e caktuara është miratuar vendimi i përmendur II1 nr. .. me datë 11.09.2019.

- Me datë 01.09.2020, me kërkesë të KSHPK është dorëzuar përgjigje nga Komuna e me shtojcë dokumentacion, me të cilën informohen se nga ana e Kryeprefektit të Komunës është vepruar në lidhje me Vendimin e miratuar nga ana e inspektoratit me datë 11.09.2019 dhe është marrë akt-vendim për ndërprerje të procedurës me datë 27.09.2019 e cila ka qenë e nënshkruar në mënyrë elektronike dhe dorëzuar deri tek parashtruesi, i cili me datë 16.08.2019 ka dhënë deklaratë të vulosur në noter me të cilën tërhiqet nga kërkesa e tij.
- Me datë 10.09.2019, me kërkesë së KSHPK është dorëzuar informim nga ana e Inspektoratit shtetëror administrativ me parashtrësia për të njëjtën, me të cilën informojnë se inspektorati administrativ është informuar se në afatin e caktuar është vepruar për Vendimin me datë 11.09.2019 dhënë gjatë inspektimit të bërë dhe nga ana e Kryeprefektit të Komunës është dhënë Vendim për ndërprerje të procedurës me datë 27.09.2019 dhe e njëjta në mënyrë elektronike është dorëzuar deri tek pala / parashtruesi dhe e njëjta është publikuar në sistemin informativ.

Në bazë të gjendjes faktike të caktuar, KSHPK konstaton se në rastin konkret në bazë të akuzave të lëndës është vepruar nga ana e organi tjetër kompetent, Inspektorati shtetëror administrativ i RMV, i cili ka vepruar me kërkesë të KSHPK dhe ka kryer inspektimin e kërkuar me datë 11.09.2019 gjatë së cilit në përputhje me Ligjin për inspektim administrativ, nga ana e inspektorit administrativ është konstatuar parregullsi – mosveprim në përputhje me nenin 54 nga LPPA, me çka nga ana e inspektorit administrativ është marrë vendim me të cilin e obligon Kryeprefektin e komunës të vepron për të njëjtën në afatin e caktuar. Njëherit, pas obligimit të dorëzuar është vepruar inspektori administrativ është informuar se

nga ana e Kryeprefektit tē Komunēs ēshtē miratuar Akt-vendim pēr ndērprerje tē procedurēs me datē 27.09.2019 dhe e nјјta ēshtē publikuar nē sistemin informativ e-tokē ndērtimore si dhe nē mēnyrē elektronike ēshtē dorēzuar deri tek pala/parashtruesi i kērkesēs. Duke pasē parasyshtē kētē gjendje faktike tē konstatuar, KSHPK vlerēson se nuk ka elemente pēr veprim tē mētutjesh pēr kētē lēndē dhe procedura pēr tē nјјtēn tē ndērpritet, kurse lēnda tē mbyllet dhe tē arkivohet.

Duke marrē parasyshtē tē gjithē tē shēnuarēn mē sipēr, Komisioni shtetēror pēr parandalim tē korrupsionit vendosi si nē dispozitat e kētij vendimi.

Ѓshtē vendosur me datē 29 dhjetor tē vitit 2020, me numēr 12-2752/5

Dorēzuar deri tek: Arkiva dhe parashtruesi

Pas pērfundimit tē KSHPK

Punoi: J. C., Kēshilltarē

Miratoi: B. I., Kryetarē e KSHPK

KOMISIONI SHTETЃRORE PЃR
PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT

Zēvendēs-kryetarē: Sofka Pejovska Dojēinovska

